



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeño/Prodato Received/Delivery	12.01.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojcë Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	241/2023		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 803/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A. Nr. 803/2021, të datës 15.09.2021, së ankuese

sipas Aktgjykimit A.Nr.2750/2021,të datës 29.11.2022,të Gjykatës Themelorë në Prishtinë/Departamenti për Çështja Administrative, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme në çështjen juridike " Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.01.2023, mori këtë:

### V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A. Nr. 803/2021, të datës 15.09.2021, të ankueses

### A r s y e t i m

Ankuesja me datë 13.07.2020 me numër protokolli 1352/2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore për kompensim material, në shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro, sipas vendimit Nr. 03/82, i datës 04.07.20212, të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Vendimit Nr. 08/170, të datës 14.02.2014, të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.08.2020, me numër protokolli 1655/2020, ka njoftuar ankuesen se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A. Nr. 188/2020, të datës 13.07.2020, për shkak se Këshilli nuk ka





korum për vendim marrje, duke e udhëzuar ankuesen që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja [redacted] lidhur me njoftimin e datës 13.07.2020 të Këshillit ka hapur konfliktin administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 03.09.2021, ka nxjerr Aktgjykim A.nr. 1670/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 30.08.2020, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr.188/2020, të datës 13.07.2020 të ankueses

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.10.2021, me numër protokoli 5015/2021, ka njoftuar ankuesen [redacted] se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A. Nr. 803/2021, të datës 15.09.2021, për shkak se Këshilli nuk ka korum, duke e udhëzuar ankuesen që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja [redacted] lidhur me njoftimin e datës 14.10.2021, të Këshillit ka hapur konfliktin administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 29.11.2021, A. Nr. 2750/2021, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 14.10.2021 duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr. 803/2021, të datës 15.09.2021 të ankueses

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova; Ankesën A. Nr. 188/2020 e datës 13.07.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A. Nr. 2750/2021, i datës 29.11.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Administrative; Njoftimi i datës 14.10.2021, i Këshillit; Njoftimi i datës 31.08.2020, i Këshillit; Aktgjykimi A. Nr. 1670/2020, i datës 03.09.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Administrative; Vendimi i datës 04.07.2012, i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimi i datës 14.02.2014, Nr. 08/170, i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 05.12.2019; Ankesë e datës 01.06.2020. 01.06.2020; Kërkesa e datës 01.12.2021, për dorëheqjeje; Vendimi i datës 22.12.2021; Vendimi i datës 21.06.2021, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 04.01.2021, me numër protokoli 01/2023.**





Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë ka konstatuar se ekzistoj rrethanat për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës së ankueses **sepse:**


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se objektin për të cilin ka filluar procedimi administrativ sipas ankesës së ankueses **lidhur me kompensim material, me shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250), euro, sipas vendimit Nr. 03/82, i datës 04.07.20212,** të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Vendimit Nr. 08/170, të datës 14.02.2014, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në lidhje me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i ka konstatuar se Këshilli lidhur me pretendimet ankimore të ankueses sa i përket kompensimit me shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro, sipas vendimit Nr. 03/82, i datës 04.07.20212, të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Vendimit Nr. 08/170, të datës 14.02.2014, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka vendosur me vendimin e datës 21.06.2021 me numër protokolli A.Nr. 399/2021, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka marrë për bazë dispozitat e nenit 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **1.Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, ose 1.2. një procedurë administrative tjetër, nisur sipas një kërkesë tjetër të paraqitur nga e njëjta palë me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, është ende në proces shqyrtimi dhe e papërfunduar"**. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se lidhur me pretendimet ankimore të ankueses Këshilli ka vendosur me vendimin A. Nr. 399/2021, të datës 21.06.2021.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
LËNDA ME NUMËR A.NR. 803/2021**

**Rushit KAJTAZI**

  
Procesmbajtës

  
**Eshref SHABANI**  
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së;